



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
DREJTORIA LIGJORE

Tiranë, më 24.10.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE**

KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbimi i Transportit, Shoqërimit dhe ruajtjes së vlerave monetare gjatë transportimit, me roje të kategorisë 1.3.B”, Marrëveshje Kuadër – me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 24 muaj

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Shërbime roje/shërbime me roje**

VLERA E FONDIT LIMIT: 495,801,600 (katërqind e nëntëdhjetë e pesë milion e tetëqind e një mijë e gjashtëqind) Lekë, pa TVSH

Në Euro: 5,147,976.33 (pesë milion e njëqind e dyzetë e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pike tridhjetë e tre) euro pa T.V.Sh

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 24.10.2025 është 1 Euro = 96.31 Lekë/Euro

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **SH.A. Posta Shqiptare**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e mosndarjes së procedurës në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Referuar specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojca 6, të DST-së, prekjet dhe kilometrat janë për një muaj dhe pagesat do të bëhen në muaj.

- *Transporti i vlerave monetare do të kryhet nga dita e hënë në ditën e premte sipas intenerareve nga arka drejt filialeve qendrore te postave ose bankave te nivelit të II për të gjitha ditët e vitit nga e hëna në të premte dhe ditën e shtunë vetëm për qytetin e Tiranës. Oraret e levizjes do të jenë nga ora 08.00-16.00 dhe; Raste të veçanta orar i*

fillimit të lëvizjeve do të jetë me heret se orari sipërcituar sipas specifikës së filialit të postës sipas AK.

- *Operatorët ekonomik, krahas formularit të ofertës, duhet të paraqesin tabelën e detajuar, ku të përfshihen të gjitha detyrimet sipas legjislacionit në fuqi për të gjithë grupin e punonjësve për lëvizjet sipas destinacionet e kerkuara ne tabele duhet të parashikojn paga bazë mujore, leje e zakonshme, shtesa për paaftesi në pune (raporte), sigurimet shoqërore, tarife arme, shpenzime uniformë, radio, shpenzime administrative, lënde djegëse, taksa e mjeteve , mirëmbajtje, siguracion dhe fitim te shoqërisë. Mosparaqitja e kësaj tabele dhe ofertimi nën koston minimale ligjore përbën shkak për skualifikimin e operatoreve ekonomik.*

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 2 prashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.
Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.
3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Theksojmë se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të pasi ndikon drejtperdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësiave duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës, ndërkohë që në thelb shërbimi është i së njëjtës natyrë. Në këto kushte, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

Akoma më tej, legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetëm paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme. Në varësi të degëve që do të marrin përsipër të mbulojnë me shërbimin e transportit dhe shoqërimit të vlerave, përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes dhe elementët koktrete që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik e njeh të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Pra duke parë natyrën, specifikat dhe përmasën e këtij shërbimi, mënyrën e operimit të “Posta Shqiptare” sh.a qe këtë shërbim e menaxhon nga një strukturë e veçantë e specializuar dhe e përqendruar, do të përbënte një kosto të shtuar për institucionin tonë në ngritjen e strukturave dhe dhenien e urdhër levizjeve nga çdo rajon, çka do ta bënte te pa mundur për realizimin e këtij shërbimi në kostot qe do ti shtoheshin institucionit tonë ndarja ne lote.

Sqarojmë se, Posta Shqiptare bën shpërndarjen e pensioneve në gjith Republikën e Shqipërisë dhe deshtimi apo tërheqja e një operatori ekonomik nga ky shërbim në një qark apo pamundësia e ofrimit të transportit si pasojë e prishjes së një automjeti do te sillte pasoja të rënda dhe impakt social negative për shoqërinë.

Po kështu vlen të përmendet se referuar edhe praktikave të viteve të tjera ku në raste të fatkeqësive natyrore sikurse rastet e përmbytjeve, rasti i termetit apo raste të tjera ku qeveria akordon fonde për individët, të cilat shpërndahen nga posta, si dhe rritja e volumeve të shërbimeve postare dhe financiare në zonat turistike në periudhën e plazhit, rrit numrin e prekjeve në filiale të veçanta duke shtuar nevojën për rritje të numrit të automjeteve të blinduara çka sjell nevojën që një numër i caktuar automjeteve mund të merren nga një qark për të ofruar shërbim në një qark tjetër për përballimin e nevojave të shtuara që mund të lindin.

Theksojmë se kjo procedurë është një procedurë e cila realizohet në mënyrë të përvitshme dhe për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij shërbimi “Transporti, Shoqërimi dhe ruajtja e vlerave monetare gjatë transportit, me roje të kategorisë 1.3.B”, ndër vite është realizuar e përqendruar në një kontratë. Procedurë e cila ndër vite është vlerësuar e drejtë edhe nga KPP-ja.

Gjithashtu duhet referuar faktit që edhe sipas komunikimit me “ILLYRIAN GUARD” SHA, e cila Sipas parashikimeve të pikës 10 të VKM-së nr. 177 datë 04.04.2019 "Për krijimin e shoqërisë “ILLYRIAN GUARD” SHA, dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin pronar të aksioneve të kësaj shoqërie" ku përcaktohet se të gjitha institucionet dhe subjektet publike, të cilat kanë në administrim objekte shtetërore, ruajtja dhe sigurimi i të cilave duhet të realizohet nga shërbime të specializuara për këtë qëllim, ka theksuar që është në fazën e përgatitjeve të plota për ofrimin e shërbimit dhe në DST të theksohet që: Në mbështetje dhe zbatim të VKM-së Nr. 177, datë 04.04.2019, palët kontraktuese bien dakord për ndërprerjen e kësaj kontratë nëse ky shërbim ofrohet me të njejtat kushte nga Shoqëria “Illyrian Guard” sh.a. dhe sapo kjo shoqëri të ketë kapacitet intelektual dhe teknike për ofrimin e këtij shërbimi, do të ndërpritet kjo kontratë dhe do të procedohet në bazë të VKM-së Nr. 177, datë 04.04.2019, me shoqërinë “Illyrian Guard” sh.a.

F

NJËSIA E PROKURIMIT